



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 74, datë 1.10.2018

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: RREGULLIMI I TARIFAVE TË
SIPËRMARRËSVE ME FNT NË TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT DHE
TRANZITIMIT TE THIRRJEVE NË RRJETET FIKSE ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës _____.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve në rrjetet fikse”

BAZA LIGJORE:

- 1) Neni 55 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
- 2) Rregullore Nr.9, “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
- 3) Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.11, datë 22.02.2018, për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve në rrjetet fikse*”
- 4) Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP:

- Nr.21, datë 30.03.2018, Për “Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”;
- Nr.22, datë 30.03.2018, Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse” ;
- Nr.23, datë 30.03.2018 Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse¹ dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- Nr.24, datë 30.03.2018 Për “Përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse*”; Dokumenti i përgatitur nga DTMRr “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar*”, i cili përmban si Aneks 1: *Komentet në Këshillimin Publik dhe Qëndrimin e AKEP për komentet*;
2. Projekt-vendimi për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse*” - *Dokument Përfundimtar*”;
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (**Relacioni**).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse* – *Këshillim Publik*”, për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye për një afat kohor 30 ditë në datat 05/04/2018 – 07/05/2018.
2. Këshilli Drejtues i AKEP:
 - a) Me Vendimin Nr.21, datë 30.03.2018, miratoi dokumentin përfundimtar: “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse”;

¹ Shërbimi telefonik GSM Fiks i tregtuar si Telekom Albania Fiks

- b) Me Vendimin Nr.22, datë 30.03.2018, përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom Sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse²”;
- c) Me Vendimin Nr.23, datë 30.03.2018 përcaktoi sipërmarrësin Telekom Albania Sh.a, sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse² dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- d) Me vendimin Nr.24, datë 30.03.2018 përcaktoi sipërmarrësit OA me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- e) Me vendimin Nr.25, datë 30.03.2018 miratoi për këshillim publik Dokumentin: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”*.

3. Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara:

- Vodafone Albania (VA) Sh.a, ka dërguar komentet e saj me shkresën nr.LEA/049/IL, datë 07.05.2018 (referenca AKEP nr.1298, datë 07.05.2018);
- Telekom Albania Sh.a (TA), ka dërguar komentet e saj me shkresën nr.3051, datë 07.05.2018 (referenca AKEP nr.1313, datë 08.05.2018);
- Albtelecom Sh.a, me shkresën Nr. 4684 prot., datë 07.05.2018 (referenca AKEP Nr.13717 prot., datë 08/05/2018).

4. Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore (DTMRr) pasi ka shqyrtuar komentet e palëve të interesuara ka përgatitur dokumentin, *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar”*, i cili:

- a) është përgatitur në përputhje me nenin 55 të Ligjit 9918 pas procedurës së këshillimit publik dhe ka marrë në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara, dhe komentet kryesore dhe qëndrimi i AKEP për komentet është pjesë e tij (Aneks 1);
- b) ka marrë në konsideratë praktikën më të mira në vendet e BE dhe rajonit dhe kushtet e tregut Shqiptar;
- c) është përgatitur në përputhje me përcaktimet në dokumentin, *Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar*, miratuar me Vendimin Nr.21, datë 30.03.2018, dhe përcaktimet e Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.22-24, datë 30.03.2018;
- a) është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm mbi të cilin bazohet arsyetimi për vendimet për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve Albtelecom sha., Telekom Albania sha dhe Sipërmarrësve të tjerë OA të përcaktuar me Fuqi

² Shërbimi telefonik GSM Fiks i tregtuar si Telekom Albania Fiks

të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe masat përkatëse rregulluese.

- b) ka një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe në përfitimet e përdoruesve fundore nga rritja e konkurrencës në tregun fiks.

5. Diskutimi i dokumentit deri në vendimmarrjen e Këshillit Drejtues ka qenë një proces dinamik i zhvilluar në disa mbledhje të Këshillit Drejtues ku janë parashtruar komente, vërejtje dhe sugjerime të cilat janë marrë në konsideratë në procesin e përmirësimit të dokumentit të analizës së tregjeve dhe masave rregullatore ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse në funksion të realizimit të qëllimit të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” për sigurimin e konkurrencës efektive.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, “Për Komunikimet Elektronike”, i ndryshuar;

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve në rrjetet fikse

Dokument Përfundimtar

(Miratuar me VKD nr.74, datë 1.10.2018)

Tabela e Përmbajtjes

1. HYRJE	3
2. ECURIA E NIVELIT TË TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET FIKSE NË SHQIPËRI...	5
3. FTR NË VENDET E BEREC	8
4. RISHIKIMI I FTR DHE TRANZITIMIT NE RRJETET FIKSE NE SHQIPERI	12
1. <i>Metoda e rregullimit</i>	12
2. <i>Glide Path</i>	13
3. <i>Opsioni i zbatimit të LRIC e pastër (pure LRIC)</i>	14
4. <i>Përfundim</i>	15
ANEKS 1: KOMENTET E PALEVE DHE QENDRIMI AKEP	16

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

<i>Tabela 1: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Albtelecom (2010-2018)</i>	5
<i>Tabela 2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fiks (2010-2018)</i>	6
<i>Tabela 3: Tarifat mesatare të terminimit ne vendet e BEREC (Korrik 2017)</i>	10
<i>Tabela 4: Metoda per rregullimin e FTR ne vendet e BEREC (Korrik 2017)</i>	11
<i>Tabela 5: Propozimi për reduktimin e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse (2018-2019)</i>	13
<i>Figura 1: Tarifat e terminimit në rrjetet fiks incumbent BEREC Korrik 2017</i>	8
<i>Figura 2: E ardhura mesatare për minutë nga terminimi në rrjetet fikse në vendet e BEREC (viti 2016)</i>	9

1. HYRJE

AKEP nëpërmjet Vendimit Nr.28, datë 27.12.2017, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Këshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut ishte 29.12.2017 -28.02.2018.

Pas marrjes së komenteve, AKEP me Vendimin Nr. 21 datë 30.3.2018 miratoi dokumentin “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse - Dokumenti Përfundimtar*”. Bazuar në përfundimet e Analizës së tregut, AKEP me Vendimet nr.22, 23 dhe 24, datë 30.03.2018, përcaktoi Albtelecom, Telekom Albania dhe 66 OA sipërmarrës me FNT në tregjet përkatës të mëposhtëme:

- Albtelecom sh.a sipërmarrës me FNT në tregjet përkatës të mëposhtëme:
 - Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të Albtelecom të ofruara nga vendndodhje fikse.
 - Tregu me shumicë i tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse”.
- Telekom Albania sha. sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve drejt numrave gjeografikë fiks në rrjetin publik telefonik të Telekom Albania.
- 66 sipërmarrës të rrjeteve publike fikse si sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse.

Ne lidhje me masat rregulluese AKEP përcaktoi që operatorët e rrjeteve telefonike publike fikse të vijnë zbatimin e masave rregulluese të percaktuara nga analiza e mëparshme e tregut të telefonisë fikse, transparenca, mos-diskriminimi, detyrimi për akses dhe interkoneksion, si dhe detyrimin për kontrollin dhe rregullimin e tarifave.

Sa i përket metodës së rregullimit të tarifave për FNT (FTR dhe tranzitim), megjithëse dokumenti i analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2017, përmbante propozimin e AKEP për rregullimin e tyre, në vijim të praktikës së kohëve të fundit me analizat e tregut si dhe komenteve të operatorëve, AKEP me Vendimin Nr. 25, datë 30.03.2018, miratoi për këshillim publik dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse*”.

AKEP vendosi që të publikojë këtë dokument të veçantë për këshillim publik, konsultim i cili u krye nga data 05.04.2018 deri me datë 07.05.2018. Në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, ky dokument është përgatitur për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve të operatorëve të percaktuara me FNT sipas dokumentit përfundimtar të analizës së tregut të miratuar më 30.03.2018.

AKEP me publikimin e këtij dokumenti për këshillim publik ka propozuar rregullimin e nivelit të tarifave të terminimit/tranzitimit në rrjetet publike të telefonisë fikse duke u bazuar në zhvillimet e ndodhura dhe pritshmëritë e operatorëve, si edhe në përvojat ndërkombëtare për këtë çështje, duke e përshtatur me kushtet e tregut Shqiptar për telefoninë fikse që karakterizohet nga një penetrim dhe përdorim shumë më i ulët në krahasim me vendet e BE dhe të rajonit, karakteristikë e ndryshme nga telefonia celulare që ka ngjashmëri me vendet e tjera Evropiane për tregues të tillë si penetrimi, mbulimi, niveli i tarifave etj.

Në përcaktimin e metodës dhe nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjete fikse AKEP ka marrë në konsideratë përmbushjen e objektivave rregullatore për nxitjen e stimujve për investime nga operatorët e rrjeteve fikse dhe rritjen e përfitimeve të përdoruesve nga shërbimet rrjeteve fikse.

2. Ecuria e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri

Në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse, miratuar ne Tetor 2015, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit dhe tranzitimit për Albtelecom sh.a dhe tarifatat e terminimit për operatorët alternativë fikse, përfshirë Telekom Albania për Telekom Albania fikse, të përcaktuar me FNT. Nëpërmjet vendimeve të vitit 2015, AKEP vendosi midis të tjerave që duke filluar nga 01.01.2016:

- Reduktimi i numrit të segmenteve të tarifimit të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse nga 2 në 1;
- Eliminimi i asimetrisë së tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të operatorëve alternativë me tarifatat e terminimit në rrjetin Albtelecom;
- Heqjen e tarifës fikse për thirrje (0.38 lek/thirrje);
- Reduktimi i tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse sipas një reduktimi të përshkallëzuar në 3 periudha (periudha e tretë nga 1.01.2018 objekt rishikimi sipas analizës së radhës së tregut fikse).

Tabelat e mëposhtme paraqesin ecurinë e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse në Shqipëri nga viti 2010 e në vijim si dhe përfshijnë dhe tarifatat e përcaktuara në vendimet e mëparshëm të AKEP dhe afatet kohore të aplikimit të tarifave sipas Analizës së tregut 2015.

Tabela 1: Tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fikse Albtelecom (2010-2018)

	1.09.2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018*	Ndryshimi 2018/17
Terminim – (lek/minute)							
Lokal	1.5	1.34	1.19	1.48	1.29	0.70	-46%
Njëfish	2.5						
Dyfish	3.5						
Tranzitim (lek/minute)							
Njëfish	1.5	1.71	1.32	0.93	0.81	0.44	-46%
Dyfish	2.5						
Tarifatat për thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38	0.00	0.00	0.00	
POI	84	12	12	12	12	2	

Shënim: Tarifatat pa TVSH

**Aplikimi i kësaj faze është shtyrë nëpërmjet Vendimit nr.28, datë 27.12.2017*

Tabela 2: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe Telekom Albania për Telekom Albania fiks (2010-2018)

	2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018*	Ndryshimi 2018/17
Operatorët Alternative							
Lokal	1.5-1.95	1.5	1.34	1.48	1.29	0.7	-46%
Mesatare-Njëfish/dyfish	2.5-3.5	2.42	1.77				
Tarife fikse për thirrje	0.83	0.53	0.38	0	0	0	
Telekom Albania							
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19	1.48	1.29	0.7	-46%
Tarife fikse për thirrje		0.53	0.38	0	0	0	

Shënim: Tarifat pa TVSH

**Aplikimi i kësaj faze është shtyrë nëpërmjet Vendimit nr.28, datë 27.12.2017*

AKEP me VKD nr.2651, datë 3.12.2015, në kuadër të shqyrtimit të ankimit administrativ të Albtelecom kreu disa ndryshime në Vendimet e datës 8.1.2015, të cilat janë reflektuar në tabelat e mësipërme. Në Vendimin nr. 2561/2015 AKEP në pjesën arsyetuese (paragrafi i fundit i pika 3/1) gjykoj se aplikimi i fazës së tretë nga 1.01.2018 duhet të jetë pjesë e rishikimit të analizës së radhës së tregut fikse:

AKEP gjykon të rëndësishme monitorimin e ecurisë së zhvillimit të rrjeteve fikse gjatë kësaj periudhe deri në analizën e tregut të radhës në vitin 2017, për të gjykuar përsëri në lidhje me fazën 3 të reduktimit të tarifave të terminimit/tranzitimit dhe efektet në rrjetet fikse në Shqipëri

Siç mund të vihet re nga tabela e mësipërme reduktim i parashikuar në 01.01.2018 impononte reduktim me 46% të FTR të të gjithë operatorëve të rrjeteve fikse si dhe të tranzitimit të Albtelecom. Kjo përbën një reduktim të konsiderueshëm edhe të të ardhurave nga terminimi për të gjithë operatorët e rrjeteve fikse dhe në kushtet specifike të Shqipërisë për rrjetet fikse (shumë rrjete fikse dhe në madhësi shumë më të vogël se vendet e BE-së, pra me ekonomi shkalle shumë të kufizuar) përbën një reduktim jo-proporcional.

AKEP nëpërmjet Vendimit nr.28, datë 27.12.2017 për miratimin e dokumentit të analizës së tregut të telefonisë fikse për këshillim publik, vendosi gjithashtu të shtyjë aplikimin e reduktimit të parashikuar më 1.01.2018 për tarifat e terminimit (të të gjithë operatorëve të rrjeteve fikse) dhe tranzitimit të Albtelecom.

Komente për FTR nga këshillimi publik i Analizës së tregut fiks

Në dokumentin e Analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik në 29.12.2017-28.02.2018, AKEP kishte përfshirë dhe propozimin për rregullimin e FTR në 2-3 vitet e ardhme si dhe pyetje për propozimin e bërë në Dhjetor 2017. Komentet kryesore lidhur me FTR janë dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut të miratuar me vendimin nr.21, datë 30.03.2018 ku më kryesoret janë:




- propozime nga Vodafone Albania për rregullimin e FTR sipas metodës benchmark me Pure LRIC si edhe për MTR apo me model kostoje (koment edhe i Telekom Albania);
- propozime i Albtelecom për vendosjen e tarifës së terminimit prej 1.51 lekë/min. dhe 1 lekë/min. për tranzitimin të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse.

AKEP ka marrë në konsideratë komentet e dërguara për FTR duke përfshirë informacion dhe arsyetime shtesë në lidhje me propozimin për rregullimin e FTR dhe tranzitimit për Albtelecom.

3. FTR në vendet e BEREC


BEREC (më parë ERG) kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Publikimet janë çdo gjashtë muaj dhe publikimi më i fundit paraqet situatën e tarifave të terminimit në Korrik 2017 në 37 vende Evropiane. Në këtë listë përfshihen 27 vendet anëtare të BE plus 10 vende të tjera Evropiane, përfshirë disa vende me status kandidat për anëtar në BE. Figura e mëposhtme paraqet tarifat e terminimit në rrjetet fikse sipas 3 segmenteve më 1 Korrik 2017.

Figura 1: Tarifat e terminimit në rrjetet fikse incumbent BEREC Korrik 2017



Siç mund të vihet re nga figurat e mësipërme, në shumicën e vendeve aplikohet një tarifë e vetme për FTR (një segment) megjithatë ka vende që aplikojnë më shumë se një segment. Figura e mëposhtme paraqet, të ardhurën mesatare për minutë nga terminimi për vitin 2016 në vendet e BEREC dhe mund të vihet re se niveli mesatar i saj ishte 0.75 euro cent apo 1.01 lek/minutë. Ndërsa në Shqipëri kjo e ardhur ishte 1.1 euro cent/minutë apo 1.48 lek/minutë.

Figura 2: E ardhura mesatare për minutë nga terminimi në rrjetet fikse në vendet e BEREC (viti 2016)



Burimi: BEREC BoR (17) 227

Në mënyrë tabelore, tarifat mesatare sipas segmenteve të terminimit janë dhënë në tabelën e mëposhtme, e cila përfshin dhe të ardhurën mesatare nga terminimi i thirrjeve në rrjete fikse në vitin 2016 si dhe mesataren e 3 segmenteve (AVG123).

Tabela 3: Tarifatat mesatare të terminimit në vendet e BEREC (Korrik 2017)

	EU July 2017		Shqipëri* /BEREC July 2017
	Euro cent/minute	Lek/minute ¹	Ndryshimi %
AV1 (W)	0.3638	0.49	43%
AV2	0.4944	0.66	5%
AV3	0.6288	0.84	-17%
AV 123	0.4957	0.67	5%
ARPM FTR (2016)	0.7500	1.01	-31%

Burimi: BEREC dhe llogaritje të AKEP

**Për Shqipërinë është përdorur niveli i synuar 0.7 lek/minute*

Sipas të dhënave të mësipërme dhe nivelit të synuar të FTR (target) prej 0.7 lek/minute të përcaktuar në Analizë 2015, rezultojnë se kjo tarifë:

- është 43% më e lartë se tarifa mesatare më e ulët në vendet e BEREC, por pothuajse e njëjtë me tarifën e dytë më të ulët mesatare të BEREC në Korrik 2017;
- është 31% më ulët se ardhura mesatare nga terminimi në vendet e BEREC në vitin 2016.

Komisioni Evropian në propozimin për kodin e ri të komunikimeve elektronike ka propozuar për vendosjen e një tarife tavan për FTR që parashikon që tarifa e terminimit në rrjetet fikse të mos jetë më e lartë se 0.14 €cent/min. dhe të rishikohet çdo 5 vjet. Ky nivel është më afër nivelit mesatar të FTR të vendeve që kanë aplikuar model Pure LRIC për terminimin në rrjetet fikse. Sipas raportit më të fundit të BEREC 22 vende kanë aplikuar model Pure LRIC për FTR deri në Korrik 2017.

Megjithatë vihet re se midis vendeve të BEREC ka variacion të madh në nivelet e FTR. Mesatarja e FTR e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër është 0.09 eurocent për minute apo 0.12 lek/minute dhe kjo është shumë më ulët se tarifatat mesatare të tabelës së mësipërme: 4 deri në 6 herë më ulët se FTR mesatare dhe rreth 8.4 herë më e ulët se ARPM nga terminimi në vitin 2016.

¹ Konvertimi në lek është bërë me Kursin e këmbimit të përdorur nga BEREC: 1 Euro=134.38 Lek

Tabela 4: Metoda për rregullimin e FTR ne vendet e BEREK (Korrik 2017)

Shteti	Modeli për llogaritjen e kostos
AL	Benchmark (Other)
AT	Pure BU LRIC
BE	FDC/FAC
BG	Pure BU LRIC
CH	BU LRAIC+
CY	Benchmark (Pure BU LRIC)
CZ	Pure BU LRIC
DE	Benchmark (Pure BU LRIC)
DK	Pure BU LRIC
EE	Benchmark (Pure BU LRIC)
EL	Pure BU LRIC
ES	Pure BU LRIC
FI	FDC
FR	Pure BU LRIC
HR	Pure BU LRIC
HU	Pure BU LRIC
IE	Pure BU LRIC
IS	Benchmark (Pure BU LRIC)
IT	Pure BU LRIC
LI	FDC/FAC
LT	Pure BU LRIC
LU	Pure BU LRIC
LV	Benchmark (Pure BU LRIC)
ME	TD LRIC
FYROM	TD LRIC
MT	Pure BU LRIC
NL	Pure BU LRIC
NO	Pure BU LRIC
PL	TD-FDC /FAC
PT	Pure BU LRIC
RO	Pure BU LRIC
RS	TD-FAC-CCA
SE	Pure BU LRIC
SI	Pure BU LRIC
SK	Pure BU LRIC
TR	BU LRAIC+
UK	Pure BU LRIC

Burimi: BEREK BoR (17) 227

Nga tabela e mësipërme vihet re se vendet e rajonit si Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia kane model te ndryshme nga Pure LRIC, dhe FTR ne këto vende janë te krahasueshme me nivelin e synuar nga AKEP prej 0.7 lek/minute.

4. Rishikimi i FTR dhe tranzitimit ne rrjetet fikse ne Shqipëri

1. Metoda e rregullimit

Sipas nenit 57 te ligjit 9918, **Metoda e rregullimit të tarifave:**

1. *AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:*

a) *përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;*

b) *korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:*

i) *kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;*

ii) *raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;*

iii) *procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;*

c) *përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.*

2. *Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:*

a) *praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;*

b) *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*

c) *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;*

ç) *raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*

d) *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*

3. *Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.*

4. *Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.*

5. *AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.*

AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit (dhe tranzitimit për Albtelecom) të thirrjeve në rrjetet fikse është metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre, prap sipas pikës 1/a të nenit 57. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP gjykon si alternativë më të mirë përdorimin e tarifave benchmark dhe praktikave më të mira në vendet e BE dhe rajonit (BEREC-që përfshin vendet e BE si dhe disa vende të rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2.

Në lidhje me nivelin benchmark të synuar, AKEP gjykon se niveli 0.7 lek/minutë i përcaktuar në Analizë 2015 është i përshtatshëm për kushtet e tregut në Shqipëri dhe ky nivel është tarifa mesatare e tre segmenteve të terminimit në vendet e BEREC në Korrik 2017. Ky nivel gjithashtu është i përafërt me FTR të aplikuar në vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor si Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia.

3. Reduktimi i përshkallëzuar (*Glide Path*)

Bazuar në dokumentin e nxjerrë për këshillim publik dhe komentet e palëve të interesuara, AKEP miraton tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse si dhe tarifa e tranzitimit të thirrjeve kombëtare të Albtelecom sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme:

Tabela 5: Propozimi për reduktimin e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse (2018-2019)

	1.01.'16	1.01.'17	1.12.'18	1.12.'19	Ndryshimi '18/'17	Ndryshimi '19/'17
Albtelecom terminim:						
Lokal/Njëfish	1.48	1.29	1.00	0.70	-23%	-46 %
Albtelecom transit kombëtar:	0.93	0.81	0.63	0.44	-23%	-46 %
OA	1.48	1.29	1.00	0.70	-23%	-46 %
Telekom Albania	1.48	1.29	1.00	0.70	-23%	-46 %

Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH

Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e parashikuar në Ligjin 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

Shtyrja me 12 muaj e arritjes së vlerës benchmark të përzgjedhur nga AKEP në vitin 2015 krijon mundësi për një reduktim më të shkallëzuar të tarifës së terminimit të të gjithë rrjeteve fikse në Shqipëri dhe rritje të stimujve për investime në këto rrjete.

4. Opsioni i zbatimit të LRIC e pastër (pure LRIC)

Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar (*glide path*) është një praktikë e ndjekur nga AKEP me transparencë në raundet paraardhëse të analizës së tregjeve përkatëse dhe është në përputhje me parashikimet e ligjit 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

Në konsultimin publik të dokumentit “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse*”, disa nga palët e interesuara kanë propozuar zbatimin e LRIC e pastër.

Reduktimet e propozuara të tarifave të terminimit nga data 01.12.2017 janë 23 % ndërsa duke filluar nga data 01.12.2019 reduktimi është me 46% në krahasim me tarifën aktuale.

Tarifa e propozuar për terminim në rrjete fikse në 1 dhjetor 2019 (0.7 lek/minutë) është sa tarifa mesatare e vendeve të BE (BEREC), por më e lartë se tarifa mesatare benchmark sipas LRIC të pastër në rrjete fikse (0.12 lek/minutë) e aplikuar në vende të BE. Siç është cituar në kapitullin e mëparshëm të këtij dokumenti, niveli mesatar i FTR i vendeve që kanë aplikuar Pure LRIC është shumë më i lartë se niveli i mesatar i të gjitha vendeve të BEREC. Këto diferenca janë shumë të larta (tarifat mesatare 4-8 herë më të larta se benchmarku me Pure LRIC), ndërkohë që për MTR diferencat midis këtyre mesatareve (mesatare e 37 vendeve v mesatare e Pure LRIC) janë shumë të ulëta dhe janë duke konvergjuar me njëra tjetrën me shpejtësi.

Edhe në analizën paraardhëse të tregut me shumicë të terminimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse AKEP ka sqaruar për karakteristikat e tregut fikse në Shqipëri:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE;
- Këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke çuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri për rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;
- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjetet fikse, jo vetëm për telefoni fikse, por sidomos për akses broadband fikse.

5. Përfundim

AKEP me anë të publikimit të këtij dokumenti miraton rregullimin e nivelit të tarifave të terminimit/tranzitimit në rrjetet publike të telefonisë fikse duke u bazuar në zhvillimet e ndodhura dhe pritshmëritë e operatorëve, si edhe në përvojat ndërkombëtare për këtë çështje, duke e përshtatur me kushtet e tregut shqiptar për telefoninë fikse që karakterizohet nga një penetrim dhe përdorim shumë më i ulët në krahasim me vendet e BE dhe të rajonit, karakteristikë e ndryshme nga telefonia celulare që ka ngjashmëri me vendet e tjera Evropiane për tregues të tillë si penetrimi, mbulimi, niveli i tarifave, etj.

Në përcaktimin e metodës dhe nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjete fikse AKEP ka marrë në konsideratë përmbushjen e objektivave rregullatore me synim nxitjen e stimujve për investime nga operatorët e rrjeteve fikse, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe rritjen e përfitimeve të përdoruesve nga këto shërbime.

Aneks 1: Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi AKEP

AKEP me VKD Nr.25, datë 30.3.2018 miratoi publikimin e dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike me vendndodhje fikse – Këshillim Publik”. Dokumenti u publikua ne faqen e internetit te AKEP dhe këshillimi publik u krye ne periudhën 05.04.2018-07.05.2018.

Në përfundim të periudhës së këshillimit publik në AKEP depozituan komentet:

- Vodafone Albania (VA) Sh.a, ka dërguar komentet e saj me shkresën nr. LEA/049/IL, datë 07.05.2018 (referenca AKEP nr.1298, datë 07.05.2018);
- Telekom Albania Sh.a (TA), ka dërguar komentet e saj me shkresën nr.3051, datë 07.05.2018 (referenca AKEP nr.1313, datë 08.05.2018);
- Albtelecom Sh.a, me shkresën Nr. 4684 prot., datë 07.05.2018 (referenca AKEP Nr.1371 prot., datë 08/05/2018).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces këshillimi për komentet dhe sugjerimet e dhëna në komunikimet e cituara më sipër.

Në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, përveç analizës së përgjithshme të tregut AKEP kishte hartuar edhe disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara. Ky Aneks më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet. Për orientim dokumenti më poshtë është strukturuar në këtë mënyrë:

I. Komente të përgjithshme

Kjo pjesë përmban komentet e dhëna nga palët e interesuara në përgjithësi për dokumentin, dhe jo në mënyrë specifike për pyetjet e këshillimit publik, si dhe qëndrimi i AKEP për këto komente të përgjithshme.

II. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik

Kjo pjesë përmban komente e palëve të interesuara të grupuara sipas pyetjeve të këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP për komentet për çdo pyetje.

Komente të përgjithshme dhe qëndrimi i AKEP

Komentet e Albtelecom

Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a, me shkresën Nr. 4684 prot., datë 07.05.2018 (referenca AKEP Nr.13717 prot., datë 08/05/2018) ka dërguar komentet dhe qëndrimin mbi dokumentin për këshillim publik *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike me vendndodhje fikse – Këshillim Publik”*, sipas Albtelecom këto komente janë në të njëjtën linjë me komentet e paraqitura nga Albtelecom me shkresën Nr.1813, datë 28.02.2018.

Komentet e Telekom Albania

Sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a (TA), ka dërguar komentet e saj me shkresën nr.3051, datë 07.05.2018 (referenca AKEP nr.1313, datë 08.05.2018).

Telekom Albania vlerëson dokumentin për këshillim publik të AKEP si një analizë e rëndësishme për të bërë një vlerësim të situatës aktuale (jo të kënaqshme) që është duke kaluar sektori i komunikimeve elektronike në Shqipëri. AKEP në të gjitha analizat e tij, si në rrjetin e telefonisë celulare, ashtu dhe në atë të telefonisë fikse dhe në vendimet e tij për masat rregullatore përkatëse duhet të evidentojë shkaqet e rënies së të ardhurave në mënyrë që masat rregullatore kundrejt operatorëve të jenë proporcionale në përputhje me kushtet në të cilat ndodhet tregu.

Në tregun e telefonisë fikse evidentohen probleme të dukshme të konkurrencës midis operatorëve për shkak të pozicionit dominant të Albtelecom si operatori inkumbent në treg i cili zotëron pjesë mjaft të larta të tregut si në terma të numrit të pajtimtarëve, thirrjeve dalëse apo totalit të të ardhurave respektivisht në nivel të 71 %, 87% dhe 60% gjatë vitit 2016. Ndaj është e rëndësishme që rregullimi i tregut me shumicë të terminimit fiks duhet të jetë i tillë që të adresojë në mënyrën e duhur problematikat në lidhje me nivelin e konkurrencës në tregun me pakicë të telefonisë fikse dhe një mjet mjaft i rëndësishëm në këtë aspekt është rregullimi dhe përcaktimi i nivelit të FTR-ve dhe të tranzitimit në rrjetin fiks të Albtelecom.

Në këtë këshillim publik për rregullimin e tarifave të terminimit fiks dhe tranzitimit në rrjetet fikse AKEP ka propozuar si alternativë për rregullimin e tarifave përdorimin e tarifave benchmark të vendeve të BEREC (vendet e BE dhe të rajonit).

Telekom Albania vlerëson se përdorimi i tarifave benchmark për caktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit në rrjete fikse (dhe tranzitimit për Albtelecom) shkakton devijime materiale në llogaritjen e kostove reale të operatorëve, duke qenë se llogaritjet që rezultojnë nga aplikimi i një modeli kostosh janë të dhëna më korrekte pasi reflektojnë saktësisht kostot që manifestojnë operatorët në ofrimin e shërbimit të terminimit në rrjetet fikse.

Telekom Albania gjykon se është i nevojshëm ndërtimi i metodologjisë BULRIC të pastër për përlllogaritjen e kostove për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të bazuara në koston LRIC të pastër, si e kërkon kuadri rregullator i BE-së pasi tarifat e propozuara nuk janë të mbështetura dhe të orientuara te kostot përkatëse për përlllogaritjet e tyre, siç shprehet qartësisht dhe në

kuadrin rregullator, më saktësisht, në nenet 45,49 dhe 57 të ligjit 9918/2012, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komentet e Vodafone Albania

Ne parim VA gjykon se uljet e forta dhe te menjëhershme te tarifës se terminimit nuk i shërbejnë qëllimit te rregullimit dhe përbën rrezik për qëndrueshmërinë financiare duke ndikuar negativisht ne nivel investimesh. Kjo qasje duhet te aplikohet gjithmonë neper analiza ku rishikohen tarifat e terminimit dhe Vodafone e ka mbështetur si ne tregun e terminimit te telefonisë se lëvizshme dhe atë fikse. Thëne kjo, *glide-path* i propozuar nga AKEP duhet te reflektoje me korrektësi dhe barazi realitetin e ofruar nga praktiket europiane, kostot qe mbartin operoret fiks përkundrejt atyre celulare dhe ne këtë mënyre te garantoje mosdiskriminim krahasuar me benchmark-un e aplikuar ndaj operatoreve celulare. Kjo gjë sigurohet duke ndjekur praktiket dhe direktivat Europiane ne lidhje me metodologjitë e aplikuar nga shtetet anëtare te BE-se për llogaritjen e tarifave te terminimit. Siç është parashikuar edhe ne raportin e 7 Dhjetorit 2017 BoR (17) 227 te BEREC dhe sipas Rekomandimit te Komisionit European 2009/396/EC date 7 maj 2009 “mbi Trajtimin Rregullator te Tarifave te Terminimit Fiks dhe Mobile ne Vendet Anëtar te BE” (“Rekomandimi”), entet rregullatore duhet te përcaktojnë tarifa terminimi bazuar ne kostot qe një operator eficient pëson. Po sipas këtij raporti vetëm 6 nga entet raportuese përdorin benchmarking ne përcaktimin e tarifave (pra jo sipas rekomandimit), por 5 nga këto përdorin Benchmarking bazuar ne Pure BULRIC dhe vetëm Shqipëria përdor reference vetëm Benchmark².

Gjithashtu, raporti i fundit i Cullen International “Tarifat e terminimit fiks dhe modeli kostove - operoret inkumbent” parashikon se për shtetet anëtare qe përdorin Pure LRIC FTR mesatarja është 0.09 Eurocent/min, ndërsa mesatarja e thjeshtë aritmetike e 27 shteteve anëtare (përfshijuar Finlandën) është 0.13 eurocent/min. Në këtë kuptim, niveli i FTR mbetet ende tepër i lartë krahasuar me kostot e operatorit eficient sipas metodologjisë pure LRIC, si dhe krahasuar me tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, te cilat janë orientuar ne kostot e operatorit eficient sipas metodologjisë pure LRIC, çka është në kundërshtim me praktikën e vendeve të BE, si më lart përmendur, ku raporti FTR/MTR është ne nivelin mesatar 1:5 në favor të MTR.

Siç edhe ju kemi vene ne dijeni ne mënyre te përsëritur, nga statistikat e BE rezulton se nivelet e MTR gjithkund janë ndjeshëm me te larta se nivelet e FTR, në një mesatare prej 5 herësh. Bazuar ne informacionin ofruar nga Cullen International (FTR është llogaritur për një thirrje mesatare lokale ku tarifa për thirrje i referohet një thirrjeje prej 3 minutash). Bazuar ne këtë reference, Vodafone vlerëson se niveli i FTR te propozuara nga AKEP mbetet ende ne nivele shume te larta krahasuar me MTR. Në këtë kontekst, Vodafone sugjeron që FTR duhet të synojë qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC, njëlloj si dhe vepruar me MTR. Gjithësesi, ky nuk mund të jetë rregull (zbatimi i një metodologjie kosto në përputhje me rekomandimin e KE), por vetëm një përjashtim. Në fakt, përjashtimisht, nëse tarifat e terminimit

² Shiko Anex 3 FTR regulatory model implemented tabela 4, faqe 35 BoR (17) 227.

caktohen sipas metodës benchmarking, është tepër e rëndësishme që kjo formë reference të reflektojë sa më shumë të jetë e mundur situatën e shtetit në të cilin po caktohen tarifat e terminimit. Kjo do të thotë që zbatimi i benchmarking (duke marrë reference vende të tjera), duhet të adresojë faktorët kyç që janë prezent në të gjitha vendet e marra si reference: përkatësisht, nëse këto shtete që po përdoren për benchmarking ndaj Shqipërisë pasqyrojnë kushtet ekonomike/gjeografike të Shqipërisë, ose nëse rezultatet nga vendet që janë përdorur për benchmarking mund të aplikohen në një mënyrë të tillë që përfshijnë dhe ndryshimet me Shqipërinë dhe impaktin e këtyre ndryshimeve në tarifat e terminimit. Duke përdorur një mesatare të thjeshtë për benchmarking, AKEP nuk arrin të trajtojë asnjë nga këto probleme dhe risku që të aplikojë një tarifë që nuk reflekton kostot e terminimit në Shqipëri të jetë i lart.

Vodafone kundërshton vlerësimin e AKEP se mbajtja e FTR ne nivele me te larta do te ndihmoje rritjen e konkurrencës ne treg dhe i përshtatet karakteristikave te tregut shqiptar dhe kostove qe mbartin operatorët e telefonisë fikse krahasuar me ata celulare - kostot e rrjetit janë gjithmonë me te larta për operatorët celulare pasi lidhen ngushtësisht me rrjetin e aksesit çka rrjedhon ne diferencën e madhe ne strukturën e kostove mes rrjeteve fiks dhe celulare siç edhe e reflekton praktika e BE.

Ne rastin e rrjetit te telefonisë fikse ky është rrjeti i telit te bakrit. Ne rastin e telefonisë celulare ky është rrjeti i stacioneve baze. Telat e bakrit i dedikohen përdoruesve te veçante dhe nuk përfshihen ne kostot e shërbimeve zanore. Kurse stacionet baze janë infrastrukture qe ndërtohet për një shumice përdoruesish dhe përfshihen ne kostot për shërbimet zanore. Mënyra me e përshtatshme për te shpjeguar sa me lart është nëpërmjet analogjisë: nëse te gjithë pajtimtarët e rrjetit te telefonisë fikse dyfishojnë numrin e thirrjeve/minutave qe ata kryejnë, nuk do te ketë investime shtese ne tel bakri. Kundërshtimisht, nëse te gjithë pajtimtarët e rrjetit te telefonisë celulare do te dyfishonin numrin e thirrjeve/minutave te kryera, numri i stacioneve baze do te rritej ne mënyre te ndjeshme. Nga ana tjetër, përhapja e gjere e shfrytëzimit te telefonisë celulare ne një treg me 3 operatore rrjeti jo detyrimisht përkthehet ne ulje kostosh për operatorët celulare, pasi avantazhet e ekonomive e shkalles nuk aplikohen si ne rastet e tregjeve me kosto te ulëta hyrjeje.

Kjo tregon qartazi se kostot e stacioneve baze janë te lidhura ne mënyre shkakësore me ofrimin e shërbimeve zanore. Kjo është dhe arsyeja thelbësore se pse regjimet e tarifave te terminimit te orientuara drejt koston gjithmonë rezultojnë ne FTR qe janë ne mënyre te ndjeshme me te ulëta se MTR, dhe kurrsesi nuk mund te ndodhe e kundërta.

Kjo theksohet gjithashtu edhe ne propozimet e Komisionit Evropian për rishikimin e kuadrit rregullator ne komunikimet elektronike (ku përfshihet dhe draftimi i një direktive për Kodin e Komunikimeve Elektronike (EEO qe mendohet te jete plotësisht i zbatueshëm në mes 2019) ku KE planifikon te vendos tarifë tavan për terminimin si më poshtë:

- 0.14 Eurocent / min për terminim fiks; dhe,
- 1.23 Eurocent / min për terminim mobile.

Komisioni European ne Rekomandimin e tij te vitit 2009 parashikon me tej ne nenin 2 se metodologjia e rekomanduar (e duhur) për te përcaktuar koston e një operatori eficient duhet te bazohet ne koston korrente dhe modelin BULRIC. Ne vijim ne nenin 4 përcaktohet se modeli i koston duhet te jete i bazuar ne teknologji eficiente te disponueshme gjate kohës se vlerësimit te modelit. Për ketë qellim, pjesa qendrore e rrjetit fiks dhe celular duhet te jete parimisht e bazuar ne Next-Generation-Netëork (NGN).

Bazuar ne sa me sipër, duke qene se pjesa qendrore e rrjetit fiks Albtelekom është tashme e bazuar plotësisht ne NGN, pra operon me një teknologji eficiente, Vodafone vlerëson se plotësohen kushtet për te kryer një analize te metodologjisë se koston FTR sipas kostove te një operatori eficient për operatoret e telefonisë fikse.

Direktiva Kuadër 2002/21/E((Frameçork Directive) parashikon ne nenin 16/1 se ‘autoritet rregullatore kombëtare, duhet që sa më shpejt të jetë e mundur pas adoptimit të një rekomandimi apo përditësimi te tij, të ndërmarrin një analizë të tregjeve përkatës duke u përpjekur maksimalisht për zbatimin e këtyre rekomandimeve’. Edhe Ligji nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton qartazi ne nenin 7 te tij se AKEP merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse te Komisionit European dhe BEREC.

AKEP duhet të mbështetet në kuadrin rregullator dhe praktikën e vendeve të BE dhe të garantoje trajtimin jo diskriminues dhe me te njëjtin standard te tarifave te terminimit si ne fiks dhe mobile. Nga ana tjetër, siç edhe praktika por edhe teoria ekonomike ka treguar, përafrimi i FTR me koston e operatorit eficient do te rezultojë ne rritjen e konkurrencës, eliminimin e ineficencave ne treg, duke nxitur operatoret ne treg për te qene me inovative dhe eficiente, çka do te reflektohet dhe ne ulje te tarifave për pajtimtarët fundore.

Ne përfundim, Vodafone e dënon një qasje te tille te njëanshme te AKEP, ku ky i fundit, duke zbatuar një standard te dyfishtë krahasuar me analizën e tregut celular (por me te njëjtin qellim qe ne mënyrë arbitrare te vendose ne pozicion te favorshëm Albtelekom - operator monopol ne infrastrukturën e rrjetit fiks ne nivel kombëtar) ka riparë përshkallëzimin dhe ka shtyre uljen e FTR me një vit tjetër pa ndonjë llogaritje te bazuar ne kosto sipas Rekomandimit te Komisionit Evropian. Nuk mund te theksojnë sa duhet faktin se AKEP, si organ rregullator, duhet te jete i paanshmen ne qasjen dhe trajtimin e tij ndaj te gjithë lojtareve ne treg dhe qëllimi i tij duhet te jete promovimi i konkurrencës se ndershme ne tregun e komunikimeve elektronike. Është e papranueshme qe AKEP te zbatoje standarde te dyfishta duke favorizuar Albtelekom dhe duke diskriminuar lojtaret e tjerë ne tregjet fikse dhe celulare, duke shkelur haptazi parimet e mos diskriminimit dhe trajtimit te barabarte midis operateve siç përcaktohet qartazi ne kuadrin Ligjor ne fuqi te Shqipërisë dhe BE.

Këto qasje te paarsyeshme ndaj te dyja tregjeve ne favor te Albtelekom, shkelin detyrimet themelore Ligjore dhe konsiderohen si diskriminuese dhe kërcënojnë konkurrencën, ne vend qe ta ndihmojnë atë; zbatimi i këtyre masave duke favorizuar qartazi njëren pale konsiderohet si

ndihme shtetërore dhe është një praktike e ndaluar nga parashikimet e kuadrit Ligjor vendas dhe atij evropian.

Qëndrimi i AKEP

Lidhur me propozimin e TA për zbatimin e LRIC te pastër, AKEP sqaron se rregullimi e tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar (*glide path*), është një praktikë e ndjekur nga AKEP me transparencë edhe në raundet paraardhëse të analizës së tregjeve përkatëse dhe është në përputhje me parashikimet e ligjit 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

AKEP është në përgjithësi dakord me konsideratat në parim të shprehura nga sipërmarrësi VA për rregullimin e tregjeve të shumicës dhe/ose pakicës sipas rrethanave respektive të konkurrencës efektive në tregjet përkatëse.

AKEP kundërshton qëndrimin e TA për qasje të njëanshme nga ana saj, duke theksuar se AKEP i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji (9918/2008) dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-it. AKEP-i nxit konkurrencën eficiente për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike.

Bazuar të dhënat statistikore të marra në analizë edhe në dokumentin përfundimtar miratuar me VKD Nr.21, datë 30.03.2018, vërehet qartë se gjatë viteve të marra në analizë pjesët e tregut të incumbent-it në shërbimet fikse janë luhatur dukshëm, operatorët alternativë në numër shumë më të lartë kanë rritur presionin konkurrues ndaj operatori kryesor duke zbehur pozicionin e Albtelecom, sidomos në disa tregje gjeografike ku operatorët alternativë kanë qenë shumë agresivë në drejtim të rritjes së numrit të abonentëve për shërbimet fikse voice dhe broadband, si dhe duke ofruar akses dhe tarifa ose paketa konkurruese.

Gjithashtu, edhe në analizën paraardhëse të tregut me shumicë të terminimit dhe tranzitimit në rrjetet fikse AKEP ka sqaruar disa nga karakteristikat e tregut fiks në Shqipëri, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE;
- këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke çuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri për rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;
- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjetet fikse, jo vetëm për telefoni fikse, por sidomos për akses broadband fiks.

Komentet sipas pyetjeve të AKEP në dokumentin për këshillim publik

1. Cili është opinioni juaj në lidhje me metodologjinë më të përshtatshme të përcaktimit të FTR të të gjitha rrjeteve fikse dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom?

Komentet e Albtelecom

Albtelecom mbështet propozimin e AKEP për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave sipas pikës 1/a të nenit 57 duke iu referuar praktikave në vendet e BE-së, ku është i evidentueshëm rasti i veçantë i Polonisë, ku ne dallim nga gjithë vendet e tjera të këtij grupi mban tarifën e terminimit prej rreth 1.51 lekë/min. Ne besojmë që janë pikërisht specifikat dhe rrethanat e veçanta në Poloni për të cilat Autoriteti Rregullator i Polonisë i ka konsideruar dhe ka përcaktuar mbajtjen e kësaj tarife terminimi, që është krejtësisht e ndryshme nga tarifa e terminimit benchmark e vendeve të tjera.

Prandaj, ashtu siç kemi argumentuar edhe me shkresën tonë Nr.1813, datë 28.02.2018 dhe gjithashtu në vijim, AKEP vendimmarrjen finale të tij të nivelit të tarifës së terminimit në rrjetin fikse duhet të konsiderojë kushtet dhe rrethanat specifike të tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, si edhe nevojën për investime të konsiderueshme për rritjen e pënetimit broadband nga vendndodhje fikse në vendin tonë.

Albtelecom gjykon se reduktimi i propozuar i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe i tarifës së tranzitimit, respektivisht në 1 lek/min dhe 0.63 lek/min nga 01.09.2018, si edhe reduktimi i mëtejshëm i propozuar nga 01.01.2019, jo vetëm është i pajustificuar, por çon në mënyrë të pashmangshme vetëm në uljen e mëtejshme të të ardhurave të operatorëve në telefoninë fikse dhe rrjedhimisht edhe në uljen të stimulit për rritje të investimeve të tyre në rrjetet fikse, për më tepër duke mos patur asnjë përfitim për përdoruesin fundor/abonentin.

Komentet e telekom Albania

Rekomandimi i Komisionit Evropian të vitit 2009, në pikën 2³ të tij parashikon se përlllogaritja e kostove të terminimit duhet të bëhet mbi bazën e modelit LRIC të kostove. Autoritetet rregullatore duhet të përcaktojnë tarifat e terminimit bazuar në kostot që shfaq një operator eficient, duke nënkuptuar simetrinë e tyre.

Edhe në ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 45, 49 dhe 57 parashikohet qartësisht kërkesa për zbatimin e

³ EC Recommendation of 7.5.2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU: 2.It is recommended that the evaluation of efficient costs is based on current cost and the use of a bottom-up modelling approach using long-run incremental costs (LRIC) as the relevant cost methodology.

parimit të orientimit të tarifave drejt kostos dhe preferencën për një model të saktë të kalkulimit të kostove përkatëse krahasuar me metodat sipas tarifave benchmark.

Telekom Albania nënvizon faktin se përdorimi i tarifave benchmark për caktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit në rrjete fikse (dhe tranzitimit për Albtelecom) ka impakt për sa i përket pozitive financiare të operatorëve dhe planeve të tyre të biznesit në terma afatgjatë, pasi shkakton devijime materiale në llogaritjen e kostove reale të operatorëve duke mos i reflektuar ato si dhe investimet e kryera dhe normës së tyre të kthimit. Ndërsa llogaritjet që rezultojnë nga aplikimi i një modeli kostosh janë të dhëna më korrekte pasi reflektojnë saktësisht kostot që manifestojnë operatorët në ofrimin e shërbimit të terminimit në rrjetet fikse. Ndërtimi i një modeli kostosh është i nevojshëm si për MTR-të ashtu dhe për FTR-të, për të pasur një trajtim të njëjtë dhe uniform për të dyja llojet e tarifave të terminimit, të cilat duhet të bazohen mbi kostot përkatëse në rrjetet celulare dhe atë fikse respektive.

- Për më tepër Albtelecom ka dhe detyrimin rregullator për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare fikse, nëpërmjet të cilave ky operator përcakton kostot përkatëse të ofrimit të shërbimeve të terminimit dhe tranzitimit në rrjetin e tij fiks, informacion ky që duhet të shërbejë si bazë për AKEP për llogaritjen dhe aplikimin e tarifave përkatëse për Albtelecom.
- Duke qenë se Albtelecom është një operator i integruar vertikalisht në tregun me shumicë të terminimit fiks dhe atij me pakicë, si dhe operon si në tregun e telefonisë fikse ashtu dhe në telefoninë celulare është shumë i rëndësishëm që aplikimi i detyrimit rregullator për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove përkatëse të mbikëqyret vazhdimisht nga AKEP. Në këtë mënyrë shmangen dhe sjellje abuzive si: subvencionim i tërthortë, ofrimi nën kosto i shërbimeve dhe i produkteve, ngjeshja e çmimit, etj. Që rrjedhin nga qenia operator dominant dhe inkumbent në treg.

Sipas raportit të BEREC⁴ BoR (17) 2277 Dhjetor 2017 "Tarifat e terminimit në nivel europian-Korrik 2017", 22 vende përdorin metodën BULRIC të pastër për rregullimin e FTR-ve në përputhje me këtë Rekomandim, 6 vende përdorin metodën Benchmarking ndërsa 5 të tjera metodën Benchmarking të bazuar në BULRIC e pastër dhe 2 vende të tjera metodën BULRAIC+, pra jo sipas rekomandimit të vitit 2009. Ndërsa Shqipëria aplikon metodën Benchmark⁵, Pra, në përcaktimin e tarifave përkatëse të interkoneksionit si pjesë e detyrimit të kontrollit të tarifave, AKEP duhet të veprojë bazuar mbi këto parime në kuadër të përcaktimit dhe rregullimit të tregjeve të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante si dhe në përputhje me parashikimet e Rekomandimit të KE-së mbi Trajtimin Rregullator të Tarifave të Terminimit fiks dhe celular.

Për sa më sipër, mbështetur dhe në pozicionet e saj të mëparshme, Telekom Albania gjykon se metoda e duhur është ndërtimi i një metodologjie BULRIC të pastër për përllogaritjen e kostove për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të bazuara në koston LRIC të pastër, siç e kërkon

⁴ BoR (17) 227 7 December 2017 'Termination rates at European level- July 2017' . faqja 14, Fig.10

⁵ Aneksi 3 "FTR regulatory model implemented" BoR (17)227, faqja 35

kuadri rregullator i BE-së, dhe më specifikisht Rekomandimi i KE-së 2009/396/EC, si dhe ai në vendin tonë.

Qëndrimi i AKEP

Për sa më sipër, lidhur me komentet e sipërmarrësve Albtelecom dhe Telekom Albania, AKEP sqaron se bazuar në parashikimet ligjore, praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe rajonit, por sidomos mbi bazën e zhvillimeve dhe ecurisë së treguesve kryesor të tregut të brendshëm të shërbimeve telefonike fikse, aktualisht metodologjia më e përshtatshme është ajo e rregullimit të tarifave nëpërmjet metodës së benchmarkut.

2. Cili është komenti juaj për rekomandimin e Vodafone Albania për qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC?

Komentet e Albtelecom

Lidhur me rekomandimin e Vodafone Albania për qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC, Albtelecom gjen të pambështetur dhe të pajustificuar rekomandimin e Vodafone dhe shpreh kundërshtimin e tij, pasi siç kemi evidentuar me shkresën nr.1813 dhe ashtu siç është vlerësuar edhe nga vetë AKEP në dokumentin për këshillim publik, kushtet, rrethanat dhe karakteristikat e telefonisë fikse në Shqipëri nuk janë aspak të ngjashme me vendet e BE dhe për më tepërme vendet që kanë aplikuar pure LRIC, që të mund të argumentohet apo justifikohet edhe në rastin e Shqipërisë kjo metodë. E kundërta qëndron në referimin e mesatares së benchmarkut të MTR-së sipas së cilës pure LRIC ku indikatorët për operatorët dominant në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri tregojnë për një “uzurpim”/tejnngopje në tregun mobile (ndryshe nga vendet e EU-së) prandaj aplikimi i “pure LRIC” pikërisht për këta operatorë në tregun mobile nuk është thjesht “i duhur” por është domosdoshmëri e menjëhershme.

Gjithashtu, në shkresën tonë të sipërpërmendur kemi arsyetuar me argumente dhe fakte konkrete se tarifat e terminimit të operatorëve të këtij tregu dhe tarifa e tranzitimit të Albtelecom nuk kanë pasur prej kohësh dhe nuk kanë aspak ndikim në tarifimin e thirrjeve me pakicë dhe me tej akoma në vendimin final të abonentit për të kryer thirrje nga rrjeti fiks, sa kohe që edhe thirrjet e ofruara falas (brenda pagesës mujore) nga operatorët alternativë dhe Albtelecom kanë përdorim shumë të vogël, dhe vijueshmërisht në ulje prej vetë abonentëve.

Nga ana tjetër, është më se evidente se çdo reduktim i tarifës së terminimit në rrjetet fikse përkthehet vetëm në uljen e mëtejshme dhe të pashmangshme të të ardhurave të operatorëve në telefoninë fikse dhe rrjedhimisht edhe në ulje të stimulit për rritje të investimeve të tyre në rrjetet fikse, duke mos pasur asnjë përfitim për përdoruesin fundor/abonentin dhe për më tepër do të vështirësonin realizimin e objektivit për përafrimin me objektivat e Digital Agenda.

Komentet e Telekom Albania

Për sa i përket rekomandimit të dhënë nga ana e operatorit Vodafone Albania për qasjen e shpejtë në mesataren e benchmarkut të FTR sipas pure LRIC, TA gjykon së pari se përcaktimi i

tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe në rrjetet fikse duhet të bazohen në të njëjtën metodologji, në mënyrë që të kihet një trajtim uniform në përlogaritjen e vlerave përkatëse të MTR-ve dhe FTR-ve, si dhe tarifave të tranzitimit në rrjetin e Albtelecom.

Për sa i përket metodologjisë që duhet përdorur në përcaktimin e tarifave të terminimit si për rrjete fikse ashtu dhe për rrjete celulare, TA vlerëson se qasja e duhur është aplikimi i modelit të kostove BULRIC të pastër, i cili duhet të jetë i njëjtë si për përcaktimin e FTR-ve ashtu dhe për MTR-të kombëtare, pasi në këtë mënyrë tarifat do të reflektojnë kostot e sakta që shfaq çdo operator në ofrimin e shërbimeve të terminimit fiks apo celular, pa pësuar devijime materiale nga këto kosto, si dhe janë në përputhje me parimin e orientimit të tyre në kosto siç e kërkon dhe ligji dhe parashikimet e kuadrit rregullator të BE-së.

Por në situatën aktuale në të cilën në tregun e telefonisë fikse, ku llogaritja e FTR-ve bëhet sipas metodës benchmarking dhe kur ndërkohë ajo për MTR-të sipas Benchmark me LRIC të pastër, tarifa e terminimit fiks (1.29lek/min ose 0.96 eurocent/min) në Shqipëri është më e lartë se:

- FTR mesatare 0.09 eurocent/min e vendeve të BE-së që aplikojnë LRIC të pastër⁶;
- Mesatarja e thjeshtë e FTR-ve prej 0.13 Eurocent/min për 27 vendet anëtare të BE-së (përfshijtur Finlandën dhe Poloninë që aplikojnë metadata FOc dhe TO-FOC /FAC përkatësisht).

Për arsyen e përmendur më sipër Telekom Albania është dakord me rekomandimin e Vodafone Albania për qasjen e shpejtë në mesataren e FTR-ve sipas LRIC së pastër.

Kjo qasje është e nevojshme duke qenë se tarifat aktuale nuk reflektojnë kostot e një operatori eficient në treg sipas LRIC së pastër, si dhe njëkohësisht trajtimi për llogaritjen e MTR-ve dhe FTR-ve nuk bazohet në të njëjtën metodologji: benchmark për FTR-të dhe benchmark sipas BULRIC së pastër për MR-të.

Qëndrimi i AKEP

Lidhur me propozimin e Vodafone për zbatimin e LRIC te pastër, AKEP sqaron se rregullimi e tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar (*glide path*), është një praktikë e ndjekur nga AKEP me transparencë në raundet paraardhëse të analizës së tregjeve përkatëse dhe është në përputhje me parashikimet e ligjit 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2. AKEP, duke u bazuar në karakteristikat e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, ecurisë dhe zhvillimeve të fundit, si edhe praktikës së ndjekur edhe nga vende të tjera të BEREC, gjykon se aktualisht metoda më e përshtatshme është rregullimi i tarifave është sipas nivelit benchmark (mesatar).

3. Cili është opinionimi juaj për propozimin e AKEP në lidhje me skemën e re të reduktimit të FTR të të gjitha rrjeteve fikse dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom?

Komentet e Albtelecom

⁶ Raporti Cullen International "Fixed termination rates and cost model-Incumbent operators". Prill 2018

Siç është parashtruar edhe me shkresën tonë nr.1813, datë 28.02.2018, qëndrimi i Albtelecom është si më poshtë:

Lidhur me skemën e propozuar nga AKEP për reduktimin e tarifave të terminimit, tarifës së tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom, gjykojmë se nuk është e justifikuar dhe nuk mbështetet për arsye thelbësore të kushteve dhe rrethanave të telefonisë fikse në Shqipëri, pjesë të konsiderueshme të të cilave janë të evidentuara lehtësisht edhe përgjatë vetë dokumentit të Analizës së AKEP, si më poshtë:

- Efekti zëvendësues në rritje i shërbimeve të telefonisë fikse me shërbime nga rrjetet celulare që ka çuar në tkurrjen e sektorit të telefonisë fikse dhe treguesve kryesorë të tij për sa i takon numrit të abonentëve, trafikut të interkoneksionit, të ardhurave, normës së penetrimit, etj. Vlen të theksojmë se, edhe pse thirrjet brenda rrjetit ofrohen falas nga pjesa më e madhe e operatorëve të telefonisë fikse, nuk ekziston as nxitja minimale e abonentëve për të kryer thirrje drejt abonentëve të tjerë të telefonisë fikse, ndërkohë që krejt e kundërta ndodh për telefoninë celulare ku ofertat në minuta të operatorëve celularë shfrytëzohen me bollëk. Për rrjedhojë, nëse rënia e numrit të abonentëve të telefonisë fikse për vitin 2017 është 3% krahasuar me vitin 2016, trafiku i Albtelecom i thirrjeve brenda rrjetit dhe i të gjithë thirrjeve dalëse drejt destinacioneve të tjera është reduktuar më shumë se 20% për vitin 2017, në disproporcion të theksuar me rënien e numrit të abonentëve.
- Ulja e konsiderueshme e trafikut të terminuar në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse, si rrjedhojë edhe e përdorimit në masë të aplikacioneve të tillë si ëhat's app, viber, dhe messenger, etj, c'ka impakton direkt të ardhurat e operatorëve nga trafiku telefonik.
- Trendi gjithnjë zbritës i të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, të cilat për Albtelecom në vecanti janë reduktuar me rreth 15% për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, ndërkohë që investimet tona në rrjetin dhe infrastrukturën e telefonisë fikse kanë vijuar në rritje si një domosdoshmëri për t'i siguruar dhe sjellë abonentit shërbim më të mirë (rritja e investimeve për vitin 2016 ishte rreth 62% krahasuar me vitin 2015).
- Vështirësia dhe pamundësia për përfitimin nga ekonomitë e shkallës si për operatorët alternativë, ashtu dhe për vetë Albtelecom për shkak të ekzistencës së një numri të madh operatorësh, që shërbejnë edhe lokalisht dhe me madhësi të kufizuar të rrjetit, të numrit të vogël të popullsisë së shërbyer, efektit zëvendësues të telefonisë celulare, etj.
- Normë penetrimi shumë të ulët dhe në rënie vit pas viti krahasuar me çdo vend tjetër të EU-së apo rajonit, si dhe trend zbritës në numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse prej vitit 2015 e në vazhdim.

Por gjithashtu, jo më pak të rëndësishme dhe me ndikim të ndjeshëm në gjendjen financiare të Albtelecom, si:

- Informaliteti i mundshëm në tregun e komunikimeve elektronike, problematikë e adresuar nga Albtelecom edhe me shkresë zyrtare pranë AKEP mbi operimin e mundshëm në rruge informale të operatorëve, çka shkakton konkurrencë të pandershme duke i dhënë mundësinë operatorëve informal për gjenerimin e të ardhurave në mënyre të padrejtë dhe uljen e të ardhurave për Albtelecom, i cili nga ana e tij përmbush me korrektësi detyrimet ligjore dhe rregullatore. Ngarkesat e vazhdueshme dhe të padrejta ndaj Albtelecom nga thellimi i aplikimit të taksave në mënyrë jo proporcionale nga njësitë e ndryshme vendore të paktën që prej vitit 2011 mbi infrastrukturën e telefonisë fikse e cila rrit kostot dhe shpenzimet dhe përkeqëson gjendjen financiare të Albtelecom.
- Dëmtimet e vazhdueshme nga të tretët në infrastrukturën e rrjetit të cilat Albtelecom detyrohet në shumicën e rasteve ti rikuperojë me kostot e veta. Edhe ky faktor ndikon ndjeshëm në kostot dhe shpenzimet e Albtelecom dhe përkeqëson gjendjen financiare të tij.

Pikërisht, duke konsideruar si shumë të rëndësishme kushtet dhe rrethanat e mësipërme, aspak të krahasueshme me vendet e tjera të EU-së apo rajonit, karakteristikat e këtij tregu në Shqipëri, është më se e qartë dhe e arsyeshme që tarifatat e terminimit dhe të tranzitimit jo vetëm të mos reduktohen, por përkundrazi, të rriten arsyeshmërisht që t'i shërbejë edhe nxitjes së investimeve në rrjetin fiks, pjesë e të cilit është edhe broadband. Kjo, për më tepër që tarifatat e terminimit të operatorëve të këtij tregu dhe i tarifës së tranzitimit të Albtelecom nuk kanë patur prej kohësh dhe nuk kanë aspak ndikim në tarifimin e thirrjeve me pakicë dhe më tej akoma në vendimin final të abonentit për të kryer thirrje nga rrjeti fiks, sa kohë që edhe thirrjet e ofruara falas (brenda pagesës mujore) nga operatorët alternative dhe Albtelecom kanë përdorim shumë të vogël, dhe vijueshmërisht në ulje prej vetë abonentëve.

Nga referimi në vendet e EU-së, është i evidentueshëm lehtësisht rasti i veçantë i Polonisë, ku në dallim nga gjithë vendet e tjera të këtij grupi mban tarifën e terminimit prej rreth 1.51 lekë/min⁷. Ne besojmë që janë pikërisht specifikat dhe rrethanat e vecanta në Poloni për të cilat Autoriteti Rregullator i Polonisë i ka konsideruar dhe ka përcaktuar mbajtjen e kësaj tarife terminimi, që është krejtësisht e ndryshme nga tarifa e terminimit benchmark e vendeve të tjera.

Prandaj, Albtelecom gjykon se reduktimi i propozuar i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe i tarifës së tranzitimit, respektivisht në 1 lek/min dhe 0.63 lek/min nga 01.09.2018, si edhe reduktimi i mëtejshëm i propozuar nga 01.01.2019, jo vetëm është i pajustificuar, por con në mënyrë të pashmangshme vetëm në uljen e mëtejshme të të ardhurave të operatorëve në telefoninë fikse dhe rrjedhimisht edhe në uljen të stimulit për rritje të investimeve të tyre në rrjetet fikse, për më tepër duke mos pasur asnjë përfitim për përdoruesin fundor/abonentin.

Kështu, me gjithë përpjekjen për të mirëkuptuar qasjen e AKEP për reduktimin e kostos së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, por nga ana tjetër:

⁷ Cullen International - Crosscountry analysisreport December 2017

- në kushtet dhe rrethanat renditur më lart, që kanë cuar vetëm në rënien e vazhdueshme të të ardhurave të operatorëve të telefonisë fikse, si dhe;
- bazuar në mos ndikueshmërinë prej kohësh tashmë të nivelit të tarifës së terminimit apo tranzitimit në përftimet e mëtejshme të përdoruesit fundor/abonentit;
- ekzistencën e të paktën një praktike në EU të tarifës së terminimit të dalluar nga vendet tjera të grupit të EU-së.

Albtelecom gjykon si të domosdoshme dhe kërkon nga AKEP vendosjen e tarifës së terminimit prej 1.51 lekë/min dhe 1 lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën tjetër të radhës të tregut të telefonisë fikse.

Në çdo rast që AKEP mund të gjykojë ndryshe, atëherë çdo lloj përcaktimi i këtyre tarifave duhet të jetë racional dhe i justifikuar me qëllim që të shërbeje konkretisht për përfitueshmërinë e përdoruesit fundor dhe për nxitjen e investimeve në rrjetet fikse dhe jo të rezultojë thjesht në tkurrje të vazhdueshme të të ardhurave të Albtelecom apo dhe të gjithë operatorëve të telefonisë fikse. Në këtë kontekst, ritheksojmë edhe njëherë se çdo lloj reduktimi i FTR-së para vitit 2019 dhe përshkallëzimi i mëtejshëm gjatë vitit 2019, për më tepër në masat respektive 23% dhe 46% të propozuar nga AKEP, në gjykimin e Albtelecom është krejtësisht i pajustificuar dhe i papranueshëm, dhe siç e theksuam edhe më lart, vetëm sa redukton të ardhurat e operatorëve dhe nuk shërben për asnjë përfitim tjetër në tregun e komunikimeve elektronike.

Propozimi i Albtelecom është për vendosjen e tarifës 1.51 lekë/min të terminimit dhe 1 lekë/min të tranzitimit të paktën deri në analizën e radhës së tregut të telefonisë fikse (tabela më poshtë):

	01.01.2016	01.01.2017	01.06.2018 - (deri në një vendim tjetër të AKEP)
Albtelecom terminim: Njëfish (kombetar)	1.48	1.29	1.51
Albtelecom transit kombëtar:	0.93	0.81	1
Operatorë Alternativë	1.48	1.29	1.51
Telekom Albania	1.48	1.29	1.51

Shënim: Tarifat janë pa TVSH

Komentet e Telekom Albania

Telekom Albania shpreh mosdakordësinë për skemën e re të reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe tranzitimit në rrjetin fiks të Albtelecom si dhe të shtyrjes së afatit të këtyre tarifave, e cila është rihedhur për propozim nga AKEP.

Tarifat e propozuara nuk janë të mbështetura dhe të orientuara në kostot përkatëse për përlllogaritjet e tyre, siç shprehet qartësisht dhe në kuadrin rregullator, më saktësisht, në nenet 45, 49 dhe 57 të ligjit 9918 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku është theksuar në mënyrë të qartë kërkesa për zbatimin e parimit të orientimit në kosto dhe preferenca për ndërtimin e një modeli të saktë për kalkulimin e kostove në përcaktimin e tarifave të interkoneksionit, në të cilat duhet të bazohet AKEP.

Shumica e vendeve të BE-së kanë implementuar tashmë modelin BULRIC të pastër për rregullimin e FTR-ve, ndërkohë që dhe Rekomandimi i KE-së për trajtimin e tarifave të FTR-ve dhe MTR-ve në pikën 4 të saj citon se:

"The cost model should be based on efficient technologies available in the time frame considered by the model. Therefore the core part of both fixed and mobile networks could in principle be Next-Gen ration- Network (NGN)-based".

- Albtelcom tashmë ka bazuar rrjetin e tij fiks në teknologjinë NGN dhe plotëson të gjitha kushtet e pikës 4 të rekomandimit për implementimin e modelit të kostove eficiente, Për më tepër ai ka dhe detyrimin rregullator për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare fikse, nëpërmjet të cilave ky operator përcakton kostot përkatëse të ofrimit të shërbimeve të terminimit dhe tranzitimit në rrjetin e tij fiks, informacion ky që duhet të shërbejë si bazë për AKEP për llogaritjen dhe aplikimin e tarifave përkatëse për Albtelcom.
- Ky propozim ndikon negativisht në planet financiare dhe të biznesit të operatorëve të tjerë dhe për Telekom Albania që kanë marrëdhënie direkte interkoneksioni me operatorin

Albtelcom të cilat janë hartuar bazuar në glide-pathin aktual që parashikon aplikimin e tarifave të reja (FTR 0.7 lek/min dhe tarifa e tranzitimit 0.44 lek/min), pasi kjo do të rrisë kostot financiare të operatorëve, duke qënë se përveç koston së terminimit për trafikun e shkëmbyer direkt me Albtelcom, operatorët fiks dhe TA i paguajnë këtij të fundit dhe për trafikun kombëtar që tranzitohet nëpërmjet Albtelcom, duke qënë me FNT në tregun e tranzitimit kombëtar.

- Rritja e koston së tranzitimit të operatorëve është një përfitim i drejtpërdrejtë financiar për Albtelcom duke e favorizuar kundrejt operatorëve të tjerë. Tarifat e tranzitimit dhe të terminimit fiks të propozuara për t'u aplikuar gjatë fazës ndërmjetëse 1.09.2018-31.12.2018 (1 lek/min dhe 0.63 lek/min) janë abstrakte, dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim lidhur me rrethanat e shtyrjes të këtij afati apo reference për përlllogaritjen e këtyre vlerave.
- Tarifat e propozuara janë shumë më të larta se sa mesatarja e FTR-ve prej 0.09 eurocen/min e vendeve të BE-së që aplikojnë pure LRIC dhe se sa mesatarja e thjeshtë e FTR-ve prej 0.13 Eurocent/min për 27 vendet anëtare të BE-së, duke mos qënë të bazuara as në benchmark LRIC së pastër.

TA është shprehur se tarifat e terminimit të bazuara në metodologjinë benchmark sipas tarifave mesatare me LRIC të pastër të vendeve të BE-së nuk i reflektojnë kostot përkatëse efektive që

operatorët manifestojnë realisht në treg, duke kërkuar nga AKEP aplikimin e një metodologjie sipas LRIC pure për përlogaritjen e kostove përkatëse të interkoneksionit për të pasur një reduktim të tarifave të orientuara në kostot reale të operatorëve, ose në mungesë të implementimit të një modeli të realizohet një qasje më të shpejtë në benchmarkun sipas LRIC së pastër, siç është vepruar dhe në përcaktimin e MTR-ve kombëtare.

Për arsyt e parashtruara më sipër, Telekom Albania nuk ndan të njëjtin qëndrim me propozimin e AKEP për skemën e re të reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe tranzitimit në rrjetin fiks të Altelecom si dhe për shtyrjen e afatit të aplikimit të këtyre tarifave.

TA kërkon që afati i aplikimit të tyre të vijojë të mbetet 1.01.2018, siç është në skemën aktuale për tarifën e interkoneksionit për rrjetet fikse.

Qëndrimi i AKEP

AKEP i qëndron propozimit të bërë në dokumentin e këshilluar me palët. Ndryshimi i propozuar për zgjatje të një faze kohore, para së FTR të arrije në vlerën 0.7 lekë, është më se e justifikueshme për vetë rrethanat e veçanta në të cilat ndodhet tregu i telefonisë fikse dhe për të mos u zgjatur në ri-përsëritje argumentesh tregu i telefonisë fikse është një nga tregjet i cili ka më pak shanse për rritje të nivelit të penetrimit dhe rrjedhimisht kërkon veçantitë e tij edhe në qasjen rregullatore pasi ndodhet njëherazi nën presionin e shumë faktorëve jo-favorizues në zhvillimin e tij. Kjo është e lidhur si me prioritetin e shërbimeve që mundëson telefonia fikse në kushtet e zhvillimit të teknologjisë, peshën e vijueshme që vjen nga presioni i telefonisë celulare, duke mos lënë jashtë konsiderate edhe ndikimin që sjellin përdorimi në masë i rrjeteve sociale si një faktor i pa llogaritur nga presioni që ushtrojnë OTT (over the top playres - operatorët e rrjeteve sociale).

Ndaj në përmbledhje të gjithë këtyre më lart si dhe argumenteve të tjerë të shtruar në dokument, AKEP i qëndron propozimit të bërë në këshillimin publik të dokumentit.